

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Avdi Dinaj-anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit A. R. nga Gjakova, për shkak të veprës penale konflikti i interesit nga neni 424.par.1.lidhur me par.4.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.105/2015 të datës 18.07.2016. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.497/2016 të datës 20.09.2016., në seancën e mbajtur më 05.12.2016., mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit A. R. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.105/2015 të datës 18.07.2016. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.497/2016 të datës 20.09.2016.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.105/2015 të datës 18.07.2016. i dënuari A. R. është shpallur fajtor për veprën penale konflikti i interesit nga neni 424.par.1.lidhur me par.4.të KPK dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 3.000 (tremijë) €, të cilin është obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh nga

plotfuqishmëria e aktgjykimit e në rast të mospagimit i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur 20 € për një ditë burgimi. Po ashtu është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor ndërsa për realizimin e kërkesës pronësoro juridike i dëmtuari është udhëzuar në kontestin civil. Me të njëjtin aktgjykim i dënuari është liruar nga aktakuza për veprat penale falsifikimi i dokumentit nga neni 434.par.1.të KPK dhe keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422.par.1.të KPK.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.497/2016 të datës 20.09.2016. janë aprovuar ankesat e të dënuarit dhe të mbrojtësit të tij dhe aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, i dënuari është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) €.

Kundër këtyre aktgjykimeve i dënuari ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit me parashtrësën KMLP.II.nr.210/16 të datës 02.11.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Nga aktgjykimet e kundërshtuara del se nuk kanë qenë kontestuese faktet se i dënuari në kohën kritike ka pas cilësinë e personit zyrtar, sepse ka punuar si avokat publik në Komunën e Gjakovës, se me datën 14.09.2012. ka lidhë kontratë për blerjen e një paluajtshmërie-pllacit i cili gjendet në Gjakovë, nga shitësi Zh. D., e cila kontratë

është vërtetuar në Gjykatën Themelore në Kralevë po me atë datë, sepse shitësi aty e ka pas vendbanimin. Më vonë, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Kuvendit Komunal të Gjakovës, ka marrë vendim për pezullim e më pas për refuzimin e regjistrimit të kësaj paluajtshmërie në Librat Publike kadastrale, ndërsa më datën 11.04.2013. i dënuari ka përpiluar ankesë kundër këtij vendimi në cilësinë e të autorizuarit të Zh. D. Ankesa i është drejtuar Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit hapësinor-Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe me këtë ankesë është kërkuar që paluajtshmëria të regjistrohet në Librat Publike Kadastrale, ndërsa Komisioni për çështje juridike, kadastrale dhe urbanistike e Komunës së Gjakovës ka marrë mendimin-rekomandimin nr.03/2013 të datës 29.10.2013. me të cilin është rekomanduar që Zh. D., të cilin e përfaqëson i dëmtuari A. R., ti jepet pëlqimi për regjistrimin e paluajtshmërisë dhe të obligohet organi kompetent në Drejtorinë për kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Gjakovës, që të bënë këtë regjistrim.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendohet se interpretimi i nenit 424. par.1.pika 4.të KPK nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë është bërë në mënyrë të gabuar për arsye se konflikti i interesit ka të bëjë vetëm me ato raste kur personi zyrtar, në çështjen për të cilën vendos vet, ka interes personal apo familjar duke përfshirë edhe rrethin me të gjerë shoqëror, ndërsa në rastin konkret nuk ka qenë ashtu sepse i dënuari vetëm e ka përfaqësuar Zh. D. dhe ka vepruar në emër të tij, por personalisht nuk ka marrë asnjë vendim. Sipas kërkesës, gjykata nuk ka bërë përpjekje të vërtetojë këtë fakte, pra, se kush ka qenë organi i cili ka marr vendim në lëndën të cilën e ka përfaqësuar i dënuari, e që është Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi si dhe Agjencioni Kadastral i Kosovës e jo Zyra e Avokaturës publike apo personalisht i dënuari. Më tutje, në kërkesë thuhet se i dënuari në mënyrë legale e ka ble paluajtshmërinë në fjalë nga Zh. D., andaj, e ka përfaqësuar në çështjen e regjistrimit të kësaj prone në Librat kadastrale, që do të thotë se nuk e ka përfaqësuar në cilësinë e personit zyrtar por në baza private dhe me këtë veprim nuk është rrezikuar interesi material apo interesi tjetër juridik i Komunës së Gjakovës apo të personit të tretë. Nga referati i këtillë i kërkesës rezulton se pretendohet se në dëm të dënuarit është shkelur ligji penal sepse ai duhej të lirohej nga akuza, me që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me vepër penale. Në anën tjetër, si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale,

pretendohet se për këtë fakt vendimtar as aktgjykimi i shkallës së parë e as ai i shkallës së dytë nuk kanë dhënë arsye e njëkohësisht është shkelur parimi i barazisë së palëve në procedurë dhe parimi i vërtetimit të saktësisë së fakteve dhe provave materiale të prezentuara nga i dënuari.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme konstaton se ato nuk janë precizuar, gjegjësisht nuk është shpjeguar se për cilën shkelje nga neni 384.të KPPK është fjala. Për më tepër, nuk është dhënë sqarim se konkretisht ku qëndrojnë mangësitë e aktgjykimeve kur është fjala për arsyetimin e fakteve vendimtare, por vetëm thuhet se ato mungojnë. Andaj, kjo gjykatë konstaton se pretendimet e këtilla nuk janë të bazuara sepse konform dispozitës së nenit 436.të KPPK Gjykata Supreme kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve të cilat në kërkesë pretendohen.

Nuk janë të bazuara as pretendimet për shkeljen e ligjit penal, sepse në gjendjen faktike e cila është vërtetuar në mënyrë të drejt dhe të plotë, drejt është aplikuar ligji penal.

Duke u nisur nga fakti se nuk kanë qenë kontestuese dhe nuk kontestohen as në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë faktet e cekura më lartë: se i dënuari e ka pas cilësinë e personit zyrtar, se ka ble patundshmëri e cila nuk ka qenë e regjistruar në Librat Kadastrale dhe e ka përfaqësuar shitësin Zh. D. duke bërë ankesë në vendimin e Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Kuvendit Komunal të Gjakovës për refuzimin e regjistrimit të këtyre, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, me vend kanë gjetur se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për marrjen e vendimit nga i dënuari apo Zyra e Avokatit Publik por për veprimet tjera e të dënuarit. Andaj, në këto aktgjykime nuk thuhet se organi i cili ka vendosur për regjistrimin e pronës ka qenë i dënuari personalisht apo Zyra e tij, por se i dënuari ka bërë një veprim tjetër-e ka përfaqësuar Zh. D. nga i cili e ka ble një paluajtshmëri, duke ushtruar ankesë kundër vendimit me të cilin është refuzuar kërkesa për regjistrimin e kësaj prone. Vendimin për ankesë nuk e ka marrë i dënuari por Komisioni për çështje juridike, kadastrale dhe urbanistike e Komunës së Gjakovës, në formë të mendimin-rekomandimit, që ti jepet pëlqimi për regjistrimin e

paluajtshmërisë dhe të obligohet organi kompetent në Drejtorinë për kadastrë, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Gjakovës që të bënë këtë regjistrim.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme për ekzistimin e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor ligji nuk kërkon që ai personalisht të jetë person i cili merr vendim por mjafton që personalisht të merr pjesë në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ka interes financiar, e si “çështje zyrtare” konform dispozitës së par.4.të nenit 424.të KPK nënkuptohet “procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare, aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar, kontratë ose kërkesë, ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit ose çështje tjetër e cila prek interesat financiare apo personale të zyrtarit apo personit tjetër.” Në rastin konkret, siç ceket edhe në kërkesë, i dënuari ka pas një interes privat-që patundshmëria të cilën e ka ble të regjistrohet në Librat kadastrale, në mënyrë që ai personalisht të jetë pronar legal, sepse këtë patundshmëri e ka ble. Në këtë mënyrë ai ka marrë pjesë në një procedurë administrative në Drejtorinë për kadastrë, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Gjakovës edhe pse në Komunën e Gjakovës e ka pas pozitën e avokatit publik. Andaj, janë përmbushur elementet qenjësore të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor dhe në dëm të tij nuk është bërë shkelje e ligjit penal ashtu që pretendimet e cekura më lartë nuk u aprovuan.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 276/2016, më 05.12.2016.

Proçesmbajtësja,  
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka